- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimin përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimin do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimin nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimin dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimin. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitivave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësitë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 613-24-8840-5-1-1/C1028

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10 % e ofertës me vlefshmëri prej 30 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, apo shprehur nominalisht: 262.626.26€
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 10 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të kontratës .
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë max 10 dite pas nënshkrimit të kontratës .
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë : 300 dit pune të ndara sipas buxhetit të siguruar nga AK për 3 vite fiskale:

		<p>Përfundimi i të gjitha Punëve do të jetë: 300 ditë pune, të ndara në tri vite fiskale, 2025-2026-2027, sipas ndarjeve buxhetore të parapara me kontrate: në vitin 2025, janë paraparë mjetet në shumë prej: 850.000.00€, viti 2026-shuma e parapara me buxhet 1.500.000.00€, kurse për vitin 2027, shuma prej 276.262.26€.</p> <p>Data e përfundimit të punëve të parapara me këtë kontrate, nuk duhet të jetë më larg se 15.03.2027.</p> <p>Çdo tejkalimi, ose mosrespektim të KPK dhe KVK, konsiderohet shkelje e afateve kohore për përfundimin e punëve dhe do të ekzekutohen penalet</p>
Dëmet e likuiduara	19.1	<p>Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë.</p> <p>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.</p>
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishite nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit caktohet: Armend Aliu, Rinor Hajrizi ndërsa MDMK caktohet Besart Zejnullahu.
Parimet e përgjithshme të pagesave	24	Pagesat do të bëhen sipas situacioneve të përfunduara ne teren dhe të pranuar nga menaxheri i kontratës duke mbajtur 10% nga secila faturë deri sa të arrin shuma 90% e mjeteve të paguara. Pjesa e mbetur për pagesë prej 10% do t'i paguhet kontraktuesit . pas leshimit të Çertifikata do të lëshohet OE sipas nenit 33 të KPK, dhe formën e publikuar nga ana e KRPP-së, CERTIFIKATË E PRANIMIT TË PËRKOHSHËM të punëve, njëashtu pas përfundimit afatit të kualitetit OE i lëshohet CERTIFIKATË E PRANIMIT PËRFUNDIMTAR, sipas manualit-doracakut të KRPP-së, i publikuar më dt 08.07.2024, nga ana e KRPP-së
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: Ska
Mbajtja e Parasë	27.1	<p>Shuma e parave të mbajtura është: 10 % e vlerës se kontratës per nje afat prej 12 muajsh pas CERTIFIKATËS SE PRANIMIT TË PËRKOHSHËM.,</p> <p>OE ka perobligim të beje permirsimin e defekteve te ketij projekti pas pranimit teknik per 12 muaj.</p> <p>Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion banker apo sigurim nga ndonje kompani e sigurimit</p>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 12 muaj,
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përçindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përçindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë
Zgjidhja	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë

<p>mosmarrëveshje ve me procedurë gjqësore</p>	<p>ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>
--	--

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

PROJEKTI: QENDRA KULTURORE

LOKACIONI: LIPJAN

INVESTITORI: KUVENDI KOMUNAL LIPJAN

VËREJTJE:

Gjatë realizimit të pozicioneve të kësaj paramase duhet referuar edhe: Përshkrimi Teknik, Projekti, Detajet, Skemat grafike dhe Specifikimet Teknike. Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punën, montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale (të kompletuar), garancinë, prezentimin e certifikatave për produktet dhe certifikatave të prodhuesve me standarde ISO ose standarde të cilat janë të cekura në përshkrim teknik apo paramase si dhe të prodhohen në përputhje me EC-standartet. Çmimi duhet të përfshijë gjithashtu të gjitha materialet shpenzuese deri në vuarjen në punë. Llogaritja e sasive përfundimtare do të bëhet pas përfundimit të pozicioneve. Të dhënat teknike, dimensionet, sasi, etj, nëpërmjet kësaj kontrate duhet të jenë me ISU - Sistemi Ndërkombëtar i Njësive (International System of Units). Të gjitha produktet e propozuara duhet të shoqërohen me një certifikatë cilësle të prodhuesit dhe të miratuar paraprakisht nga mbikëqyrësi. Në rast mospërputhjeje midis të dhënave në paramase dhe Përshkrimi Teknik, ku përshkrimi teknik gjithmonë duhet të merret i pari, duke përjashtuar rastet e gabimeve teknike eventuale ku metoda më e favorshme është se duhet miratuar zgjidhja. Nëse për shkak të neglizhencës në punë shkaktohet dëmtim në zonën përreth kantierit dhe brenda kantierit, atëherë përgjegjësi për rregullimin i takon kontraktorit. Materiali i demoluar, mbeturina, dheu etj që nuk ka ndonjë vlerë konsiderohet pronë e pronarit dhe pronari do të japë udhëzime për asgjësimin apo deponimin e materialit të demoluar, ndërsa demolimi dhe transporti janë përgjegjësi e kontraktorit. Çmimi për skelери duhet të përfshihet në çdo pozicion ku nevojiten për përfundimin e punimeve apo realizimin e atij pozicioni. Çmimet duhet të përfshijnë çdo aktivitet tjetër që nuk përshkruhet këtu, por që është i nevojshëm për përfundimin e punimeve apo realizimin e pozicionit. Kontraktori është i detyruar të bëjë matjet e të gjitha pozicioneve, para fillimit të prodhimit dhe furnizimit. Për çdo ndryshim të projektit gjatë realizimit apo ndryshim të materialit paraprakisht duhet të merret aprovimi nga projektuesi.

I PUNËT NDËRTIMORE					
1.01 PUNËT PARAPERGADITORE DHE DEMOLIMIT					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1.01.01	Rrethimi dhe sigurimi i punishtës me konstruksion metalik dhe llamarinë të zinkuar me lartësi 2 m në tërë perimetrin e caktuar të punishtës dhe shënjëzimi informativ me tabelën informuese me dimensione 1.5x2 m të punuar nga profilet e hekurit dhe llamarina.	komplet	1.00	24,500.00	24,500.00
1.01.02	Organizimi i punishtës dhe depove, furnizimi me material dhe ndërtimi i rrjetit të përkohshëm të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik dhe ndriçimit të kantierit, vendosja e kontejnerit për zyren e menaxhimit të projektit dhe vendosja e ËC kabinave për nevojat e punëtorëve.	komplet	1.00	2,550.00	2,550.00
1.01.03	Pozicionimi gjeodezik dhe shënjëzimi i objektit për ndërtim	komplet	1.00	500.00	500.00
1.01.04	Pastrimi i tërësishëm i terrenit/punishtës nga të gjitha ndërtimet e përkohshme, rrethojat, pemet, llsat, mbeturinat inerte dhe ambalazhet	komplet	1.00	12,500.00	12,500.00

	e paketimet e materialeve, etj.				
1.01.05	<p>Pergaditja e punishtes per fillimin e punimeve e cila perfshine: Pastrimi i pergjithshem i terenit ne komplet siperfaqen e parcelles e cila ka siperfaqe S=7550.10 m², demolimi i pllatove nga asfalti apo betoni, demolimi, skajoreve, kubezave, kanaleve nga betoni, murit rrethues te parcelles dhe largimi i instalimeve mbitokesore dhe nentokesore, laurave, shtyllave elektrike, lodrave, etj. Demolimi/rrenimi i objektit ekzistues B+P+1+Nk me siperfaqe baze S=1520 m² me themele dhe konstrukcion te vrazhde nga konstrukcioni i betonit dhe pjesa tjeter nga konstrukcioni i drurit, rrenimi i objektit te behet pas largimit te inventarit qe ndodhet brenda tij. Demolimi dhe dislokimi i instalimeve me te cilat eshte i lidhur objekti. Verejtje: Ne kete pozicion perfshihen te gjitha punet per pastrimin e parcelles deri te pergaditja e parcelles per fillimin e punimeve(germimit).Transporti i mbeturinave deri ne deponi e cila percaktohet nga ana e Autoritetit Kontraktues.</p>	komplet	1.00	45,500.00 €	45,500.00
TOTAL POZICIONI				1.01	85,550.00

1.02 PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1.02.01	<p>Gërmimi i shtresës së humusit dhe dheut me trashësi 50 cm në tërë sipërfaqen e paraparë për pozicionimin e objektit. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkriftësisë. Vërejtje: Një sasi e dheut duhet të mbetet në punishte për mbushjet eventuale dhe modelimin e oborrit.</p>	m ³	1,462.50	5.00	7,312.50
1.02.02	<p>Gërmimi i dheut me makineri dhe dorë deri në 435 cm thellësi (kuota -4.35) për hapjen e themeleve për punimin e themelplakes dhe bodrumit objektit, rampave dhe gropën e berthamës së ashensorit. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkriftësisë.</p>	m ³	5,898.40	5.00	29,492.00

1.02.03	Gërmimi i shtresës së humusit dhe dheut me trashësi deri 40 cm në tërë sipërfaqen e paraparë për platonë dhe shtigjet e këmbësorëve dhe pjesës së parkingut që lidhet me rrugën. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkurtësimit.	m ³	3,278.30	5.00	16,391.50
1.02.04	Furnizimi me material dhe punimi i tamponit nga zhavori me trashësi 50 cm me fraksion 0/150 në tërë sipërfaqen e objektit nën pllakën e themellit dhe nën bërthamat e ashensoreve duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arritjen e kompaktësisë Mv=50 MPa.	m ³	1,948.90	16.00	31,182.40
1.02.05	Furnizimi me material dhe punimi i tamponit nga zhavori me fraksion 0/63 në tërë sipërfaqen e objektit nën pllakën e themellit dhe nën bërthamat e ashensoreve duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arritjen e kompaktësisë Mv=50 MPa.	m ³	913.50	16.00	14,616.00
1.02.06	Furnizimi me material dhe punimi i tamponit nga zhavori me fraksion 0/31.5 në tërë sipërfaqen e objektit nën pllakën e themellit dhe nën bërthamën e ashensorit duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arritjen e kompaktësisë Mv=50 MPa, t=25cm	m ³	664.80	16.00	10,636.80
1.02.07	Furnizimi me material dhe mbushja e hapësirës përgjatë mureve perimetrike të objektit, mureve të bodrumit si dhe rreth bërthamës së ashensorit duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arritjen e kompaktësisë MS=40 MPa, T=25 cm	m ³	1,619.35	16.00	25,909.60
1.02.08	Ngjeshja e dheut me mekanizëm deri në arritjen e kompaktësisë MS=60 MPa të dheut për ndërtimin e objektit.	m ²	2,412.70	5.00	12,063.50
TOTAL POZICIONI				1.02	147,604.30

1.03	PUNËT E BETONIT				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI ME TVSH	TOTALI ME TVSH
	<p>VËREJTJE 1: Punëkryesi është i obliguar që të merr mostrat e betonit për çdo 'parti' betoni, të kujdeset për mirëmbajtjen e tyre, dërgimin në laboratore të specializuara për shqyrtimet e nevojshme dhe sigurimin e raporteve përkatëse për të gjitha mostrat.</p> <p>VËREJTJE 2: Për pozicionet e parapara të betonohen me shtesa të specifikuar si më poshtë punëkryesi obligohet që të veproj sipas udhëzimeve të prodhuesit duke ju përmbajtur reçetës së përzierjes, duke respektuar raportet e përzierjes ujë-çimento-agregat ndërsa aditivet e kërkuara duhet të shtohen në mikser pas ardhjes në punishte në praninë e organit mbikqyrës.</p>				

1.03.01	Furnizimi me material dhe punimi i bazës në tërë sipërfaqen e objektit për mbështetjen e shtreses së hidroizolimit. Betonimi të bëhet me beton të varfër të markës c-16/20 me trashësi min.8 cm mbi tamponin e zhavorit, duke përfshirë edhe nivelimin horizontal. Gjerësia e betonimit të jetë së paku nga 10 cm më e gjerë në të gjitha anët e pllakës së themeleve.	m ³	155.00	95.00	14,725.00
1.03.02	Furnizimi me material dhe punimi i bazës në tërë sipërfaqen e objektit mbi shtreën e hidroizolimit për mbrojtjen e saj gjatë punimit të pozicionit vijues. Betonimi të bëhet me beton të varfër të markës c-16/20 me trashësi min.8 cm mbi tamponin e zhavorit, duke përfshirë edhe nivelimin horizontal. Gjerësia e betonimit të jetë së paku nga 10 cm më e gjerë në të gjitha anët e pllakës së themeleve.	m ³	155.00	125.00	19,375.00
1.03.03	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i themelit pllakë. Betonimi të bëhet me beton të markës c-30/37 me aditiv kristalor për arritjen e padepërtueshmërisë nga uji, në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos.Punimi i dyshemese të behet me FER beton.Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ³	1,075.00	125.00	134,375.00
1.03.04	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i mureve perimetrike të themeleve me trashësi 25 cm. Betonimi të bëhet me beton të markës c-30/37 me aditiv kristalor për arritjen e padepërtueshmërisë nga uji, në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit. VËREJTJE: Tek muret e betoni duhet të jetë beton i natyralizuar i cili nuk duhet të suvatohet por kallëpet duhen të jenë speciale në mënyrë që faqet e jashtme të mureve të jenë të pastërta.Pahitë për kallëpim të betonit duhet të jenë metalike, pas largimit të pahive, sipërfaqja e betonit duhet të pastrohet nga papërsosshmëritë nga rrjedhja eventuale e lëngut të betonit ndërmjet pahive.	m ³	197.00	125.00	24,625.00

1.03.05	<p>Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i themeleve dhe mureve te rampes per qasje ne bodurmin e objektit. Betonimi të bëhet me beton të markës c-30/37 me aditiv kristalor për arritjen e padepërtueshmërisë nga uji, në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.</p> <p>VËREJTJE: Tek muret e betoni duhet të jetë beton i natyralizuar i cili nuk duhet të suvatohet por kallëpet duhen të jenë speciale në mënyrë që faqet e jashtme të mureve të jenë të pastërta. Pahitë për kallëpim të betonit duhet të jenë metalike, pas largimit të pahive, sipërfaqja e betonit duhet të pastrohet nga papërsosshmëritë nga rrjedhja eventuale e lëngut të betonit ndërmjet pahive.</p>	m ³	184.50	125.00	23,062.50
1.03.06	<p>Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i shtyllave me dimensione 60x60 cm, 50x50 cm, 30x60cm, D=40cm, mureve te shkalleve t=25cm, muret anesore t=25cm si dhe mureve nga betoni i armuar për bërthamën e ashensorit. Shtyllat perimetrike të betonohen deri në kuotën e parapare tek pjesa grafike. Betonimi të bëhet me beton të markës c-30/37, me aditiv kristalor për arritjen e padepërtueshmërisë nga uji, në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.</p> <p>VËREJTJE: Para betonimit duhet të verifikohen dimensionet dhe pozita e hapjes për dyert e ashensorit varësisht nga specifikat e tipit/markës së ashensorit të propozuar/aprovuar. Tek shtyllat dhe muret e betoni te punuara deri ne kuotën ±0.00m duhet të jetë beton i natyralizuar i cili nuk duhet të suvatohet por kallëpet duhen të jenë speciale në mënyrë që faqet e jashtme të mureve të jenë të pastërta. Pahitë për kallëpim të betonit duhet të jenë metalike, pas largimit të pahive, sipërfaqja e betonit duhet të pastrohet nga papërsosshmëritë nga rrjedhja eventuale e lëngut të betonit ndërmjet pahive.</p>	m ³	685.30	125.00	85,662.50
1.03.07	<p>Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi pllakë së përdheses dhe trajeve në kuotën ±0.00 me trashësi 25 cm. Betonimi të bëhet me beton të markës c-30/37 me aditiv kristalor për arritjen e padepërtueshmërisë nga uji, në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.</p>	m ³	420.40	125.00	52,550.00

1.03.08	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i pllakave meskatëshe me trashësi 25 cm (niveli + 5.45) dhe trarët me lartësi totale h=75 cm, trajet 40x50cm si dhe konzollat e strehëve me përfundimet e tyre të lëshuara në të gjitha anët e përcaktuara me projekt duke përfshihet edhe betonimin e shkallëve të brendshme me pllaken e mbuleses mbi ashensor. Betonimi të bëhet me beton të markës c-30/37. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit. VËREJTJE: Gjatë betonimit të pllakave duhet ti kushtohet kujdes dimensioneve të hapjes së ashensorit dhe përfundimit në nivelin e fundit.	m ³	236.50	125.00	29,562.50
	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i TRAUT PERIMETRIK SHTANGUES cerklazheve horizontale (përgjate shtyllave kryesore) me dimensione 50x25 70x25 60x60 cm. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ³	62.60	125.00	7,825.00
1.03.09	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i cerklazheve horizontale (trarët mbi dyer dhe dritare) me dimensione 12x20 15x20 25x20 cm. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit. OE duhet te posedon edhe nje automikser vetngarkues per prodhim betoni	m ³	8.50	125.00	1,062.50
1.03.10	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i shkallëve dhe rampave/pjerrinave (pllakes) tek hyrje/daljet para objektit, duke përfshirë muret e rampes si dhe pllaken e rampes për qasje në bodrum. Betonimi të bëhet me beton të markës c-30/37 me aditiv kristalor për arritjen e padepërtueshmërisë nga uji në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Pozicionet duhet të realizohen si elemente të mbështetura mbi tokën/zhavorin e ngjeshur duke u lidhur me muret perimetrike të themelit me anë të ankerave të lënë më parë. Në çmim të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ³	315.85	125.00	39,481.25
TOTAL POZICIONI				1.03	432,306.25

1.04	PUNËT E ARMIMIT				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI ME TVSH	TOTALI ME TVSH
	Furnizimi me material, prerja, lakimi dhe lidhja e armaturës për formimin e elementeve të armaturës së brinjëzuar sipas planeve dhe specifikimeve të armaturës. Të gjitha armaturat duhet të jenë të kualitetit B500B, sipas standardit EN-10080 dhe duhet jenë të pastra nga korozioni. Në çmim të përfshihet përdorimi i distancerave të llojeve të ndryshme në varësi të pozicionit me qëllim të arritjes				

së trashësisë së duhur të shtresës mbrojtëse.

1.04.01	Ø8,Ø10,Ø12,Ø16,Ø20,Rrjete Q-335	kg	476,876.25	1.10	524,563.88
TOTAL POZICIONI				1.20	524,563.88

1.05 PUNËT E KONSTRUKSIONIT METALIK					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1.05.01	<p>Furnizimi me material dhe punimi i mbuleses se konstruksionit metalik. Konstruksioni metalik duhet të punohet me profilet e specifikuara ne pjesen grafike te projektit.</p> <p>Mbrojtja e konstruksionit metalik nga korozioni me 2 shtresa ngjyrë bazë (primer) dhe dy shtresa ngjyrë të yndyrshme me nuancë të hirtë/antracit. Paraprakisht të pastrohen të gjitha sipërfaqet metalike nga pluhuri dhe korozioni.</p> <p>Vërejtje: Të perfshihet edhe shtangimi i fasades strukturale prej xhamit me konstruksion metalik si dhe konstruksionin per punimin e fasades traventini.Të gjitha profilet metalike duhet të jenë të reja, të papërdorura, të padëmtuara dhe pa shenja korozioni. Të merren të gjitha masat që të mbrohen nga korozioni gjatë deponimit të tyre. Të gjitha punët e saldimit duhet të kryhen nga saldues të çertifikuar. Saldimet të jenë të plota, uniforme, pa vrima të cilat nuk mund të mbrohen nga korozioni. Të gjitha vijat kontaktuese në mes të profile duhet të jenë plotësisht të mbyllura me saldim.</p> <p>Per te gjitha ngjyrat,profilet,bulonat,plakatat etj duhet te behen paraaprovime dhe secila prej tyre te posedoj çertifikatat nga prodhuesi.</p>	kg	188,278.90	2.10	395,385.69
1.05.02	<p>Furnizimi me material dhe punimi i konstruksionit metalik per plafonin e leshuar . Konstruksioni metalik per shtangimin e plafonit te leshuar duhet të punohet me profilet e specifikuara tek pjesa grafike e projektit.</p> <p>Mbrojtja e konstruksionit metalik nga korozioni me 2 shtresa ngjyrë bazë (primer) dhe dy shtresa ngjyrë të yndyrshme me nuancë të hirtë/antracit. Paraprakisht të pastrohen të gjitha sipërfaqet metalike nga pluhuri dhe korozioni.</p> <p>Vërejtje: Të gjitha profilet metalike duhet të jenë të reja, të papërdorura, të padëmtuara dhe pa shenja korozioni. Të merren të gjitha masat që të mbrohen nga korozioni gjatë deponimit të tyre. Të gjitha punët e saldimit duhet të kryhen nga saldues të çertifikuar. Saldimet të jenë të plota, uniforme, pa vrima të cilat nuk mund të mbrohen nga korozioni. Të gjitha vijat kontaktuese në mes të profile</p>	kg	32,670.00	2.10	68,607.00

	duhet të jenë plotësisht të mbyllura me saldim. Per te gjitha ngjyrat,profiilet,bulonat,pllakat etj duhet te behen paraaprovime dhe secila prej tyre te posedoj çertifikatat nga prodhuesi.				
TOTAL POZICIONI				1.20	463,992.69

1.06	PUNËT E MURATIMIT				
	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1.06.01	Furnizimi me material dhe muratimi i mureve me trashësi 25cm,20cm dhe 12cm me blloqe të argjilës së pjekur, Giter G5 të lidhura me llaç të fituar me përzlerjen e rërës me lëndë lidhëse të gatshme në raport 3:1. Fuga horizontale në mes të mureve dhe trarëve dhe pllakës të mbushet me shkumë montuese poliuretani për shtangim.	m ³	740.70	85.00	62,959.50
TOTAL POZICIONI				1.06	62,959.50

1.07	PUNËT E SUVATIMIT DHE NGJYROSJES				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1.07.01	Furnizimi me material dhe suvatimi i sipërfaqeve të brendshme të mureve deri në nivelin e pllakës meskatëshe në të gjitha kthinat në përdhese dhe katin e parë si dhe suvatimi i plafoneve në kthinat pa plafon të lëshuar, me material/llaç të parapërzler (gëlaqere+çimento+agregat) ose me material të ngjashëm me trashësi 15 mm. Në çmim të përfshihet trajtimi paraprak i bazës me llaç sprucues ose material të ngjashëm, listelat metalike për caktimin e trashësisë së llaqit, këndoret metalike, listelat dilatuese (anputzlesite) nga plastika me rrjetë armimi dhe shirit vetngjithës për dyer dhe dritare dhe mbrojtja e të gjitha pozicioneve të zdrukthtarisë me folle të PVC-së si dhe rrjeta e PVC-së me fije qelqi për përforcimin e llaçit në çdo pjesë ku kalohet nga një material në tjetrin si blloqe-beton.	m ²	8,942.45	3.10	27,721.60
TOTAL POZICIONI				1.07	27,721.60

POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1.9.01	<p>Furnizimi me material dhe punimi i mureve perimetrike te bodrumit. Muri perimetrike duhet të realizohet me shtresat si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lyerja bazë • Ngjithës - masë hidroizoluese • Termoizolim XPS 30 t=3 cm • Hidroizolim Sikaplan 14.6 (mbivendosja e shtresave është 30 cm) • Termoizolim XPS 30 t=5 cm • Foli PVC (fundoline) <p>Në çmim duhet të përfshihen të gjitha elementet e nevojshme si profilet bazë, profilet këndore me rrjetë, kunjat përforcues të plastikës, rondelat termoizoluese etj për fiksimin dhe sigurimin e plotë të cokllës.</p>	m ²	986.00	28.00 €	27,608.00
